




KOMPANIA UJËSJELLËSI RAJONAL SH.A.
REGIONAL WATER COMPANY J.S.C.
REGIONALNA KOMPANIJA ZA VODOSNABDEVANJE D.D.
PRISHTINA



D P A

Departamenti për punë administrative
Department for administrative works

Prishtinë me 29.12.2023

Nr.

Kryeshefi Ekzekutiv i KRU „Prishtina“ sh.a. në Prishtinë, në harmoni me nenin 16 pika 2 të Statutit të KRU “Prishtina” SH.A. në Prishtinë, nenit 17 pika 2 dhe 3 e Ligjit të punës Nr. 03/L-212 duke, duke analizuar performancën gjatë vitit 2023 të ushtruesit të detyrës të Drejtorit Teknik, pas një analize, marrë këtë:

V E N D I M

Për lirimin nga punët dhe detyrat e punës

I.

Z. Sokol Xhafa **I i r o h e t** nga punët dhe detyrat e punës të ushtruesit të detyrës të Drejtorit Teknik të KRU „Prishtina“ sh.a. në Prishtinë.

II.

Lirimi në vështrim të pikës I. të këtij Vendimi është bërë pasi i njejtë nuk ka treguar performancën e pritur dhe mosveprimet e tij kanë ndikuar që ndërmarrja të ketë edhe ngecje në sektorin që të cilin e ka udhëhequr dhe në sektorët që janë atakuar nga mospuna e tij.

I përmenduri kthehet në punët dhe detyrat e mëhershme të punës – **Inxhinier i Hidroteknikës** dhe rangohet me pagë 780.00.Euro.

Arsyetim

Pas analizës së punës së Z. Sokol Xhafa lidhur me punët dhe detyrat e punës të ushtruesit të detyrës të Drejtorit Teknik gjatë periudhës janar-dhjetor 2023 është konstatuar se si pasojë e mos kryerjes në mënyrë efikase të punëve që lidhen me përshkrimin e pozitës në fjalë kanë ndikuar që ndërmarrja të ketë edhe ngecje në sektorin që ky e ka udhëhequr dhe në sektorët që janë atakuar nga mospuna e tij, si vijon:

Mosmenaxhim i duhur i problemeve teknike si rritja e vlerës së manganit në liqenin e Badovcit, duke mos vepruar pothuajse fare asgjë e duke propozuar zgjidhje imagjinare dhe të pamundura teknikisht, përfshirë këtu edhe propozimet e perealizueshme në takimin e mbajtur në IKSHP dhe Zv. Ministrat e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ekonomisë.

Moskontribuimi në përpilimin e dhe realizimin e planit të veprimit, që si rezultat disa pika të këtij plani nuk janë realizuar sipas afateve të aprovuara nga Bordi i Drejtorëve. Mosrealizimi i projekteve kapitale të cilat janë financuar nga fondet vetanake të KRU Prishtina, deri në dhjetor janë realizuar më pak se 30% e investimeve kapitale të parapara me buxhet si rezultat i mospërgaditjes dhe mosinicimit me kohë të projekteve nga drejtoria teknike.

Mosrealizimi dhe mosmenaxhimi i duhur i projekteve kapitale të cilat janë financuar nga donatorë qoftë në të kaluarën por edhe gjatë këtij viti si psh projektet e realizuar nga CDI Zvicerrane ku ende këto projekte janë të papërfunduara dhe të paregjistruara si asete të Kru Prishtina si pasojë e mungesës së dokumentacionit të nevojshëm lidhur me këto projekte.

Raportet e këqija, moskomunikim dhe moskordinim me kolegët tjerë në ndërmarrje, përfshirë këtu zyrtarët e lartë të ndërmarrjes.

Raportim joreal i punës në raportet mujore/tremujore të Drejtorisë teknike, përfshirë këtu edhe mosraportimin real të prodhimit/trajtimit të ujit e që janë konstatuar edhe me auditim nga NJAB.

III.

Obligohet Z. Sokol Xhafa që më largu deri me dt. 31.12.2023 deri në ora 16:00 të dorëzojë veturën kurse deri me dt. 05.01.2024 të bëjë pranim dorëzimit e zyrës pranë komisionit përkatës.

IV.

Për ekzekutimin e këtij Vendimi kujdeset Departamenti për Administratë, Divizioni i Autoparkut dhe ai për Kontabilitet dhe Financa i Kompanisë.

V.

Ky Vendim hynë në fuqi menjëher pas nënshkrimit nga Kryeshefi Ekzekutiv i Kompanisë.

VI.

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi punëtori ka të drejtë ankese në Organin e Shkallës së Dytë në KRU “Prishtina” Sh.A. brenda 8 ditësh nga dita e marrjes së vendimit.

U dërgohet:

- Dosiës,
- Punëtorit,
- Sh.Llogarit.
- Arkivit.

**Kryeshefi Ekzekutiv
Arsim FETAHU**

